

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA	
	KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT OPSTINA.J MITROVICA/ MUNICIPALITY OF S.MITROVICA	
	Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia	

NR.PROT	01-052/01-0040069/26
Datë	30.06.2026
PËR/ TO:	z. Faton PECI - Kryetari i Komunës
NGA/ FROM:	znj. Fitore MEHMETI BEHRAMI - Drejtoreshë e Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia
TEMA/ SUBJECT:	Raporti i Punës për periudhën Janar-Qershor 2026

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia në muajin Janar për vitin 2026 aktivitetin e vet të programuar dhe të planifikuar nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka realizuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Ligjin Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, Ligjin Nr. 04/L-049 për Zjarrfikëse dhe Shpëtim, Udhëzimet Administrative, Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Komunës, Vendimet e Bordit të Drejtorëve si dhe aktet tjera normative të cilat e rregullojnë këtë fushë.

I. Gjatë muajit **Janar** Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia ka hartuar dhe azhurnuar këto plane:

- Raportin e punës vjetor për Drejtorinë për Siguri dhe Emergjencia për vitin 2025;
- Hartimin e Plan-Programit të punës së Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia për vitin 2026.
- Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit **Janar** ka realizuar edhe këto detyra:
Zyrtarët e drejtorisë kanë qenë të angazhuar në terren për t'u ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga vërshimet.
Së bashku me Nënkryetarin e Komunës, Drejtorinë për Mirëqenie Sociale dhe Drejtorinë e Inspekcionit është realizuar vizitë te familjet e prekura nga vërshimet e fundit, me qëllim të vlerësimit të situatës në terren dhe ofrimit të përkrahjes institucionale.

Është mbajtur takim me komisionin për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore, ku është shqyrtuar situata aktuale në terren dhe procesi i evidentimit dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Për shkak të dëmeve të konsiderueshme materiale kemi formuar edhe dy komisione AD-HOC për vlerësimin e dëmeve, një komision është formuar për të bërë vlerësimin e dëmeve në bujqësi dhe komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara te bizneset, me qëllim të reagimit të menjëhershëm në teren.

Së bashku me zyrtarët e drejtorisë kemi pasur një takim koordinues me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës në Stacionin Policor në Jug.

Së bashku me Nënkryetarin e Komunës, Drejtoreshën e Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit është realizuar një vizitë në Njësinë për Zjarrfikje dhe Shpëtim për tu njohur më afër me punën e tyre. Kemi qenë në vizitë në Qendrën Multifunksionale “Omni Sport” për tu njohur nga afër me aktivitetet dhe shërbimet që kjo qendër ofron për qytetarët ku pjesë e takimit ishin Nënkryetari i Komunës dhe Drejtori për Mirëqenie Sociale.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Janar**, përmes zyrës për shërbim me qytetarët të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 223 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet.

- Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit **Shkurt** ka realizuar këto detyra:

Kemi mbajtur një takim me koordinatorin e Qendrës Operative Emergjente Regjionale në Mitrovicë në kuadër të AME-së.

Është intervenuar në rrugën Misiri i Vogël për pastrimin e lumit Lushta.

Pas telefonatës nga 112 së bashku me përfaqësuesit e Zjarrfikësve, KEDS/KEK, KOSTT kemi dalur në terren në rrugën “Ali Pashë Tepelena” në lagjen e Bair për vlerësimin e gjendjes në teren ku tri familje ishin në rrezik për të qëndruar në shtëpitë e tyre.

Kemi mbajtur një takim në zyrën e Inspektoratit të Punës me Udhëheqësen e Divizionit të Inspektiveve në Rajonin e Mitrovicës.

Kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e UNICEF-it ku jemi dakorduar për mbajtjen e një ushtrimi një ditë për evakuimin e nxënësve nga objektet shkollore.

Kemi qenë pjesë e një stimulimi rutinor për alarmin e zjarrit në kolegjin Kosovo Leadership Academy, për të parë nga afër procesin e evakuimit të nxënësve, procedurat përkatëse dhe organizimin e përgjithshëm të ushtrimit ku pjesë e këtij simulimi të pranishëm ishin edhe njësitë i zjarrfikësve.

Gjithashtu kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e lagjes Bair ku kemi diskutuar për mundësinë e zgjedhjes së problemeve që janë duke kaluar banorët me rastin e rrëshqitjes së dheut dhe dëmtimeve të shtëpive, ku në koordinim me banorët, AME dhe Komunën të bëhet një zgjidhje afatgjatë për banorët e kësaj lagje.

Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Shkurt**, përmes zyrës për shërbim me qytetarët të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme ka pranuar 14 kërkesa me shkrim nga qytetarët të cilat i ka shqyrtuar duke angazhuar komisionet e formuara për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet.

- Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit **Mars** ka realizuar këto detyra:

Së bashku me zyrtarët e drejtorisë kemi qenë pjesë e tryezës me temën “Barazia Gjinore në Nivel Lokal” nga politikat në zbatim, organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me organizatat CECD Friends, Mitrovica Women Association for Human dhe Business Women Mitrovica.

Kemi përgatitur dhe dorëzuar në Kuvendin Komunal- **Raportin mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut - Janar 2026.**


Diskutimi u zhvillua në lidhje me rolin e rëndësishëm të gruas në shoqëri dhe politikat mbështetëse që duhet të implementohen për fuqizimin e tyre.

Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe MMPHI ja kemi dërguar Raportin Teknik mbi Vlerësimin e dëmeve, shkaqet dhe rrezikun për banorët e Lagjes Bair, Mitrovicë 2023-2026.


Kemi intervenuar në një pjesë të Lumit Trepça me qëllim të rregullimit të shtratit të lumit, për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore eventuale, si vërshimet.

Po ashtu është intervenuar në një pjesë të lumit Lushta me qëllim të pastrimit të shtratit të lumit, për të parandaluar dhe mbrojtur nga fatkeqësitë natyrore eventuale.









Kemi qenë pjesë e ditës Ndërkombëtare të pyjeve së bashku me ekipet të përbëra nga vullnetar, përfaqësues të Drejtorisë së Mjedisit dhe Pyjeve, Agjencionit të Pylltarisë, Kryetari i Komunës së bashku me kabinetin e tij, si dhe organizata të ndryshme proambientaliste.

Gjithashtu kemi marrë pjesë në takimin rajonal “ Gratë në Qeverisjen Lokale” të organizuar nga National Democratic Institute, ku është diskutuar rëndësia e përfshirjes aktive të grave në qeverisjen lokale si një faktor kyç për zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të shërbimeve publike.

Së bashku me zyrtarët e drejtorisë kemi pasur një takim me përfaqësuesit e Shoqatës së Kërkim Shpëtimit me të cilët kemi biseduar për një memorandum bashkëpunimi.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Mars**, përmes zyrës për shërbim me qytetarët të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 10 kërkesa me shkrim nga qytetarët.

- ✓ Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit **Prill** ka realizuar këto detyra:

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shëndetësisë, SHML të mjekësisë Dr “Xheladin Deda”, Kryqin e Kuq, Policinë e Kosovës, Njësinë për Zjarrfikje dhe Shpëtim dhe QKMF kemi realizuar një ushtrim për evakuimin e nxënësve dhe stafit të shkollës.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte rritja e nivelit të gatishmërisë, forcimi i koordinimit institucional dhe ngritja e ndërgjegjësimit për reagim të shpejtë dhe efikas në situata emergjente.

Kemi marrë pjesë në një takim mes NJPZSH dhe përfaqësuesit e KFOR-it Amerikan, me rastin e pranimit të një donacionit me pajisje për zjarrfikësit.

Po ashtu është arritur një memorandum bashkëpunimi mes NJPZSH dhe KFOR-it Amerikan me qëllim ngritjen e kapaciteteve operacionale dhe rritjen e efikasitet në shërbim të qytetarëve.

Njësia për Zjarrfikje dhe Shpëtim ka realizuar disa intervenime operative, shuarjen e zjarrit në fshatin Rahovë, ku është djegur një sipërfaqe mali, si dhe në fshatin Kçiq ku ka ndërhyrë në shuarjen e zjarrit në një shtëpi e cila është djegur.

Kemi mbajtur takim me Komisionin për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore, ku kemi diskutuar për mundësinë e zgjedhjes së problemeve me të cilat po përballen banorët, si pasojë e rrëshqitjes së dheut dhe dëmtimeve të shtëpive në lagjen Bair.

Me rastin e ditës së tokës së bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Njësinë për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Kryqin e Kuq, Shoqatën e Kërkim Shpëtimit, është realizuar një aktivitet për pastrimin e hapësirave publike në qytet dhe në fshatrat e Komunës së Mitrovicës.

Po ashtu, drejtorja ka qenë e angazhuar në një aksion mobilizimi për kërkimin e një personi të zhdukur.

Në kuadër të Mitrovica Women Association for Human Rights kam qenë pjesë e tryezës së rrumbullakët me temën “ Pjesëmarrja e grave në proceset e vendimmarrjes dhe paqes”

Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Prill**, përmes zyrës për shërbim me qytetarët të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 10 kërkesa me shkrim nga qytetarët .

- Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit **MAJ** ka realizuar këto detyra:

Në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Zjarrfikësve, në Mitrovicë u organizua një aktivitet vetëdijësues ku njësia e zjarrfikësve demonstroi aftësitë dhe gatishmërinë e saj në përballje me situata emergjente.



Në këtë aktivitet morën pjesë stafi i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Drejtoresha e Policisë në Mitrovicë, përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, Shoqata për Kërkim Shpëtim si dhe Komandanti i Njësisë për Zjarrfikëse dhe Shpëtim në Mitrovicë.

Me këtë rast, u theksua roli i rëndësishëm i zjarrfikësve në mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve, si dhe përkushtimi i tyre i vazhdueshëm në shërbim të komunitetit.

Kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e UNICEF-it ku kemi biseduar lidhur me një projekt pilot komunal mbi Veprimin Paraprak të ndjeshëm ndaj fëmijëve për gatishmërinë ndaj përmbajtjeve në Mitrovicë.

Së bashku me Drejtoreshën për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Drejtoreshën për Bujqësi dhe Zhvillim Rural kemi zhvilluar një takim me Drejtoreshën Rajonale të Policisë, me fokus forcimin e bashkëpunimit institucional dhe koordinimit ndërmjet institucioneve.

Në takim u theksua rëndësia e komunikimit dhe mbështetjes së ndërsjellë në shërbim të qytetarëve dhe rritjes së sigurisë publike.

Së bashku me zyrtarët e Drejtorisë kemi qenë për vizitë në Kryqin e Kuq, ku kemi biseduar për rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional si dhe për shkëmbimin e përvojave në funksion të mbështetjes së qytetarëve në nevojë.

Në bashkëpunim me Ujësjellësin Rajonal janë ndërmarrë masat e nevojshme për shpërndarjen e ujit të pijshëm për banorët e Trepçës dhe Rahovës të cilët kanë mbetur pa furnizim me ujë të pijshëm si pasojë një defekti në trafon e energjisë elektrike në Flotacionin e Tunelit të Parë.

Gjithashtu në koordinim me Kryetarin e Komunës dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është realizuar një vizitë në lagjen Bair me qëllim të vlerësimit të situatës së banorëve të rrezikuar nga shembja e dheut në këtë lagje.

Kemi qenë pjesë e aktivitetit të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe UNDP-në në kuadër të fushatës ndërgjegjëse "Festo me zemër, jo me armë" i mbajtur në SHML "Hasan Prishtina".

Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë gjatë muajit **Maj**, përmes zyrës për shërbim me qytetarët të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 3 kërkesa me shkrim nga qytetarët.

- Drejtorja për Siguri dhe Emergjencë përveç detyrave të lartë përmendura gjatë muajit **Qershor** ka realizuar këto detyra:

Kemi filluar me kontrollimin, mbushjen dhe servisimin e aparateve kundër zjarrit në objektin e Komunës së Mitrovicës dhe objektin e QKMF-së.

Kemi mbajtur mbledhjen me Këshillin Lokal për Siguri dhe Emergjencë ku pjesë e takimit kanë qenë: Nënkryetari i Komunës, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, përfaqësuesit e Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi, Drejtori i Arsimit, përfaqësuesi i Komunitetit për Komunitete, përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme etj.

Kemi mbajtur takim me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës dhe Shërbimin për Zjarrfikje dhe Shpëtim ku gjatë takimit u diskutuan çështje që lidhen me parandalimin e zjarreve, luftimin e dhunës në familje dhe rritjen e sigurisë në komunitete. Palët u dakorduan për bashkëpunim të mëtejshëm në realizimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe informues për qytetarët.

Është organizuar një takim koordinues lidhur me masat parandaluese dhe gatishmëri institucionale për sezonin veror, me fokus të veçantë në parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve.

Në këtë takim morën pjesë Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë, Drejtoresha për Mbrojtje dhe Mjedis, Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi, Policia e Kosovës, Qendra Operative Emergjente, Njësia për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Ujësjellësi Rajonal dhe Kryqi i Kuq.

Gjatë takimit u diskutua për rreziqet e mundshme nga zjarret gjatë muajve të verës, të cilat paraqiten si pasojë e temperaturave të larta.

Gjithashtu, u shqyrtuan masat parandaluese, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe gatishmëria e institucioneve për reagim në raste emergjente.

Po ashtu kemi qenë pjesë e punëtorisë “Siguria e grave në Mitrovicë, përvojat e sfidat dhe zgjedhjet e përbashkëta.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projektit “Women and Youth in Decision Making and Peace Processes”

Ishim pjesë e punëtorisë së organizuar nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave/ Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Bankën Botërore.

Objektivi i punëtorisë është të forcojë parashikimin e bazuar në ndikim në nivel qendror dhe lokal dhe përmirësimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për shumë Rrezeqe në Kosovë.

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca gjatë muajit **Qershor**, përmes zyrës për shërbim me qytetarët të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit ka pranuar 5 kërkesa me shkrim nga qytetarët.